



Prishtinë, 12.11.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1320_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 9, 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 16, Paragrafi 1.11 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085),
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë (Ligji_Nr._05_L-081),
- Dispozitat e Nenit 12 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 05.11.2019 për shqyrtimin dhe aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2020 – 2029”

në seancën e mbajtur me datë 12.11.2020 nxori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet dokumenti “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2020–2029” i KOSTT-it

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05.11.2020 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2020 – 2029” të KOSTT SH.A. Në ndërkohë dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e ZRRE për diskutim publik. ZRRE ka dhënë komentet e veta si dhe ka kërkuar analiza shtesë për disa projekte, të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.

ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, dhe se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, kështu që Bordi i ZRRE-së ka aprovuar “Planin Zhvillimor të Transmetimit 2020 – 2029”.



II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bordi i ZRRE-së;

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar